




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Procesverbal i konsultimit publik me Grupin e Grave për Qarkoren e parë Buxhetore e vitit 2024/01 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026



INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik me Grupin e Grave për Qarkoren e Parë Buxhetore e vitit 2024/01 dhe KAB-in për vitet 2024-2026, u publikua me datë: 12.06.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Kalendar-i-konsultimeve-publike-per-Qarkoren-e-Pare-Buxhetore-2024-dhe-KAB-2024-2026.pdf>

Në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon: *Komuna e Rahovecit Komuna e Rahovecit përmes grupit punues për përgatitjen e Buxhetit të Komunës për vitin 2024, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit. Nr. 1005 i datës, 29.3.2017 dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, kryetari i Komunës së Rahovecit në bashkëpunim me Zyrën për Informim, publikojnë kalendarin për organizimin e konsultimeve publike me qytetarë për buxhetin e vitit 2024 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), për vitet 2024-2026.*

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së konsultimeve publike, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendarin i konsultimeve publike për katër (4) konsultime publike në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Kalendar-i-konsultimeve-publike-per-Qarkoren-e-Pare-Buxhetore-2024-dhe-KAB-2024-2026.pdf>

me datë: 12.06.2023.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar Grupi i Grave, rreth mbajtjes së konsultimit me anë të publikimit të njoftimit, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së konsultimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik për Qarkoren me Grupin e Grave që veprojnë në Komunën e Rahovecit u publikua me datë: në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Konsultim-publik-me-grupin-e-Grave.pdf>

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber.

KONSULTIMI PUBLIK NË RAHOVEC

Konsultimi publik me Grupin e Grave që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 21.6.2023 në objektin e Shoqatës Hareja, me fillim në ora 14:00.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë konsultim publik ishin ekzekutivi i komunës dhe zyrtar komunal ishin:

- Femra ishin: 3
- Meshkuj ishin: 3

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin:

- Femra ishin: 24
- Meshkuj ishin: 1

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë konsultim publik.
Konsultimin e shpalli të hapur Nënkryetari i Komunës, z. Fatmir Iska.

Prezantimin e Qarkores dhe KAB-it e bëri Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, z. Afrim Limani.

Afrim Limani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar përfaqësues të OJQ-ve, ju të pranishëm. Faleminderit që sot jeni këtu.

Jemi sot këtu në konsultim publik për, për të marrë kërkesat tuaja si OJQ, prioritetet që ju keni dhe më pas t'i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2024.

Buxheti për vitin 2024 do të jetë 20.034.785.00 Euro, Paga dhe medijtë në vlerë prej 10.300.983.00 Euro, Mallra dhe Shërbime në vlerë prej 2.466.340.00 Euro, Shërbime Komunal në vlerë prej 370.000.00 Euro, Subvencione dhe Transfere në vlera prej 890.000.00 Euro si dhe Investimet Kapitale kapin vlerën prej 6.007.462.00 Euro. Ju lus që kërkesat edhe pasi t'i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokoluara si sjellni dhe në Komunë, që më pas të cëdohen nëpër drejtoritë përkatëse.

Fjalën e keni ju.

Adelina Paqarrizi, drejtore e SHPG Hareja: Të nderuar përshëndetje, i nderuar ekzekutiv dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne. Ne si shoqatë përveç grave në qytet i vizitojmë edhe grate në zona rurale.

E falenderoj Kryetarin që vazhdimisht e përkrah shoqatën Hareja-fëmijët me nevoja të veçanta.
Pas konsultimeve me gra ne i kemi listu disa kërkesa-nevoja.

Kërkesat:

- Numri i grave të moshuara është shumë andaj kërkojmë përkrahje- në bazë të projektit në vetëm për 27-gra të moshuara mund të kujdesemi,
- Lirimi i trotuarëve,
- Të ndahet buxhet për aktivitetet e ndryshme si 8 Marsin, Tetori muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit etj,
- Ndriçim i rrugës, "Abdullah Bugari",
- Rregullimi i hapësirës së jashtme të Shoqatës,
- Përkrahje për grate që jettojnë vetëm,
- Të ndahen më shumë bursa për student femra,
- Të ketë më shumë granë pozitive udhëheqëse.

Fahrije Thaqi, Xërxë: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje!

Kërkesat nga unë janë:

- Kur do të funksionalizohet çerdhja në Xërxë-ndoshta do të kishte qenë më mire që ajo çerdhe të shëndrrohet në strehë për grate e moshuara, për arsye së nuk ka shumë fëmijë.

Drenushë Abazibra, Rahovec: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje!

- Probleme me qentë endacak,
- Probleme me ndriçim publik.

Edita Hasku, Rahovec: Të nderuar përshëndetje, i nderuar ekzekutiv i komunës dhe ju të pranishëm!

Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga unë janë:

- Lidhur me shtesa për lehonat- a nuk është diskriminim që vetëm ato gra që lind në QKMF-në në Rahovec të përkrahen.

Agron Neziri, Rahovec: Të nderuar përshëndetje, të nderuar ekzekutiv i komunës dhe ju të pranishëm!

Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Një kërkesë nga unë: Fëmijët me nevoja të veçanta 3 herë në javë vijnë në Shoqatën Hareja, a ekziston mundësia që të jenë 5 herë në javë.

PËRGJIGJET E EKZEKUTIVIT NË PYETJET E PËRFAQËSUESËVE TË OJQ-ve.

Fatmir Iska, Nënkyetar: Ju përgëzoj për projektin për kujdesjen e grave të moshuara. Lidhur me kërkesën për lirim të trotuareve, është shqetësues që paraqet pengesa dhe është punë që duhet të bëjë Inspektorati dhe Policia.

Ndarja e buxhetit për fushata sensibilizuese-Ne si komunë ju kemi përkrahur dhe të vazhdojmë përsëri. Ndriçimi i rrugës mbrapa zyrës së KEDS-it,- Ne kemi një kontratë për ndriçimin digjital. Mbulimi i shpenzimeve komunale për gratë e moshuara,-Komuna nuk ka kod për këtë, mirpo i mbështet me ndihmë momentale.

Te përkrahja e bursave, dje është publikuar lista e përfituesve të bursave në bazë kriteresh ligjore.

Komuna e ka një shtëpi për të moshuar e cila është në fazën përfundimtare dhe po presim të funksionalizohet.

Problemi me qent endacak, nuk e di sa është e drejtë me pasur fermë në vendbanim. Komuna jonë ka kontratë për trajtimin e qenve endacak.

Te pyetja e Zyrafete Delibeqa, ne e kemi ndërtuar murin në atë pjesë, si dhe pritet të bëhet edhe kubëzimi e asaj hapësire.

Për Edita Hasku,-Ideja ka qenë me i stimuluar gratë të lindin në QKMF-në në Rahovec.

Afrim Limani: Faleminderit juve që jeni prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja.

Mirë u takofshim!

Konsultimi publik përfundoi në orën: 15:04.

LISTAT E NËNSHKRIMEVE

Republika e Kosovës
Republika e Kosovës / Republika e Kosovës
Komuna e Rahovecit
Opština / Računat / Mesta, opština / Računat

Lista e nënshtkrimeve të grupeve përfaqësuese në konsultim publik për Qarkun e Puntë (të hapura 2024) dhe K.A.H për vitin 2024-2026

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Përfaqësuesi
1.	...	...	...	...
2.	...	...	...	...
3.	...	...	...	...
4.	...	...	...	...
5.	...	...	...	...
6.	...	...	...	...
7.	...	...	...	...
8.	...	...	...	...
9.	...	...	...	...
10.	...	...	...	...
11.	...	...	...	...
12.	...	...	...	...
13.	...	...	...	...
14.	...	...	...	...
15.	...	...	...	...
16.	...	...	...	...
17.	...	...	...	...
18.	...	...	...	...
19.	...	...	...	...
20.	...	...	...	...

NR 21.6.2023

Republika e Kosovës
Republika e Kosovës / Republika e Kosovës
Komuna e Rahovecit
Opština / Računat / Mesta, opština / Računat

Lista e nënshtkrimeve të grupeve përfaqësuese në konsultim publik për Qarkun e Puntë (të hapura 2024) dhe K.A.H për vitin 2024-2026

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Përfaqësuesi
1.	...	...	...	...
2.	...	...	...	...
3.	...	...	...	...
4.	...	...	...	...
5.	...	...	...	...
6.	...	...	...	...
7.	...	...	...	...
8.	...	...	...	...
9.	...	...	...	...
10.	...	...	...	...
11.	...	...	...	...
12.	...	...	...	...
13.	...	...	...	...
14.	...	...	...	...
15.	...	...	...	...
16.	...	...	...	...
17.	...	...	...	...
18.	...	...	...	...
19.	...	...	...	...
20.	...	...	...	...

NR 21.6.2023



FOTOGRAFI



Rahovec: 23.6.2023

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

